

Axhenda

## “32 VJET HISTORI SINDIKALE TË PUNONJËSVE TË SEKTORIT TË TELEKOMUNIKACIONIT”

**Ekspozitë Fotografike**

04 Maj 2023

Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit (TKOB)

E enjte, 4 Maj 2023	
19:00	Mbërritja dhe Regjistrimi i Pjesëmarrësve
19:15	Fjalë përshëndetëse e të Ftuarve: <ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Renato Mucaj</b> – Kryetar i Sindikatës së Punonjësve të Postë Telekomit Shqiptar</li><li>• <b>Stine Klapper</b> – Drejtoreshë e Fondacionit “Friedrich Ebert”, zyra e Tiranës;</li><li>• <b>Ado Wilhelm</b> – Sindikata Gjermane Ver.di, Berlin</li></ul>
19:45	Vizitë e Ekspozitës Fotografike
20:15	Pritje dhe Rrjetëzim

## PËRSHKRIM I SHKURTËR HISTORIK I SPPTSH

Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar (SPPTSH), është një sindikatë sektoriale në të cilën aderohet punonjësit e sektorit të telekomunikacionit, postës dhe gjithashtu është e hapur për të gjithë sektorët privat që i perkasin disa fushave të profesioneve të tjera, ashtu edhe për sindikatat e profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë. Themelimi i Sindikatës së bashkuar të PTT-së në të gjithë Shqipërinë u vendos në vitin 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky kongres u zgjodhën edhe drejtuesit e parë të SPPTSH-së ku kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, zv/kryetar. z. Shpëtim Vojka dhe sekretar z. Aleksandër Miraj. Disa nga kongreset dhe kryetarët e zgjedhur ndër vite janë:

- Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka
- Kongresi III 2001- z. Aleksandër Miraj
- Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj
- Kongresi VII 2017 – z. Renato Muçaj
- Kongresi VIII 2018 – z. Renato Muçaj

SPPTSH është themeluar mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojtë dhe të promovojë interesat e anëtarëve të saj, në lidhje me vendin e punës dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPTSH rregullon marrëdhënien midis punëdhënësve dhe punonjësve të punës në kompanitë ONE ALBANIA (Albtelecom & One), TELEPERFORMANCE ALBANIA, MAKHES ALBANIA. SPPTSH është e shtrirë në të gjithë Shqipërinë me disa qendra rajonale. Gjithashtu, është anëtare në Federatën Ndërkombëtare të Sindikatave të Shërbimit, UNI GLOBAL UNION, e cila është ndër më të mëdhatë me mbi 20 milionë punonjës, nga 900 sindikata në 140 vende të ndryshme të botës.